

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
MISIONI NË KOSOVË**

**Procesi i zhvillimit të buxheteve komunale në Kosovë:  
Vlerësim krahasues i proceseve të vitit 2012 dhe 2013**

**Prill, 2013**

***Mohim:***

Versioni zyrtar i këtij publikimi është në gjuhën angleze. Versionet në gjuhë të tjera të këtij publikimi janë përkthim i origjinalit në gjuhën angleze dhe nuk janë dokument zyrtar.

## PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	3
1. <b>HYRJE</b> .....	4
2. <b>PROCEDURAT PËR PËRGATITJEN DHE MIRATIMIN E BUXHETEVE VJETORE KOMUNALE</b> .....	5
3. <b>ANALIZË KRAHASUESE E RESPEKTIMIT TË KRITEREVE PËR ZHVILLIMIN E BUXHETIT NGA KOMUNAT PËR BUXHETIN E VITIT 2012 DHE 2013</b> .....	7
<b>3.1 Respektimi i afateve për zhvillimin e procesit buxhetor</b> .....	7
<b>3.2 Takimet e organeve legjislative komunale për zhvillimin e buxhetit</b> .....	9
3.2.1 <i>Pasqyrim i takimeve të organeve legjislative për zhvillim të buxhetit komunal</i> .....	9
3.2.2 <i>Njoftimi publik për takimet e organeve legjislative lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal</i> .....	10
3.2.3 <i>Pjesëmarrja publike në takimet e organeve legjislative për zhvillimin e buxhetit komunal</i> .....	12
<b>3.3 Takimet publike për zhvillimin e buxhetit komunal</b> .....	15
3.3.1 <i>Pasqyrë e takimeve publike për zhvillimin e buxhetit komunal</i> .....	15
3.3.2 <i>Njoftimet publike për takimet publike për zhvillimin e buxhetit komunal</i> .....	17
3.3.3 <i>Pjesëmarrja publike në takimet publike për zhvillimin e buxhetit komunal</i> .....	18
4. <b>PËRFUNDIMI</b> .....	21
5. <b>REKOMANDIMET</b> .....	23
SHTOJCA 1 .....	25

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Ky raport vlerëson procesin e zhvillimit të buxhetit komunal për vitin 2013 dhe analizon shkallën e përputhshmërisë së institucioneve komunale me kornizën ligjore në krahasim me vitin e kaluar fiskal.

Çdo shtator, nga komunat e Kosovës kërkohet t'i miratojnë buxhetet vjetore për vitin e ardhshëm fiskal. Si dega e ekzekutivit ashtu dhe ajo e legjislativit të strukturave qeverisëse komunale kanë përgjegjësi ligjore karshi zhvillimit dhe miratimit të buxhetit vjetor komunal. Komunat duhet të zhvillojnë dhe dorëzojnë dy dokumente kyçe në Ministrinë e Financave – një kornizë afatmesme buxhetore dhe një propozim-buxhet, të dyja këto duhet të miratohen nga kuvendi komunal i komunave gjegjëse.

Respektimi i afatit për miratim të kornizës afatmesme buxhetore nga kuvendet komunale dhe komitetet për politika dhe financa është përmirësuar në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011, derisa miratimi me kohë i propozim-buxhetit për vitin 2013 nuk ishte fare sfidë për komunat.

Buxhetet komunale caktojnë ndarjen e burimeve të pakta komunale; duke qenë kështu, pjesëmarrja publike në zhvillimin e buxhetit komunal mund të kontribuojë në krijimin e një buxheti që reflekton nevojat dhe prioritetet e banorëve dhe tregon përkushtim nga institucionet e nivelit lokal në respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë të transparencës dhe llogaridhënies. Në vitin 2012, në krahasim me vitet e kaluara, OSBE-ja ka vërejtur 80 për qind ngritje në numrin e takimeve publike të thirrura nga komunat me qëllim të marrjes së mendimit të publikut për prioritetet buxhetore. Megjithatë, shumica e komunave ende nuk i ndjekin hapat e kërkuara të konsultimit publik përkitazi me atë se kur duhet të kërkohet informacioni nga publiku dhe nga cilat organe komunale (ekzekutivi ose legjislativi).

OSBE-ja ka vërejtur se komunat kanë bërë përpjekje në zbatimin e disa rekomandimeve të paraqitura në Raportin e vitit 2012. Megjithatë, ministria e linjës, komunat dhe organizatat e shoqërisë civile inkurajohen të vazhdojnë me zbatimin e atyre rekomandimeve. Veç kësaj, OSBE-ja e inkurajon Ministrinë e Financave që të rris nivelin e shkëmbimit të informacioneve me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal gjatë procesit të zhvillimit të buxhetit komunal për t'i adresuar mangësitë e mbikëqyrjes legjislative të procesit. Në anën tjetër, komunat duhet të ofrojnë përditësim të rregullt për zhvillimin e procesit buxhetor në takimet e organeve legjislative komunale. Komunat, gjithashtu, do të duhej ta informonin publikun përkitazi me shkallën e përfshirjes së kërkesave të tyre në propozim-buxhet. Përfundimisht, komunat duhet të mbajnë kontakte të ngushta me zyrtarët komunalë për barazi gjinore dhe grupet e grave në kuvende komunale për të siguruar pjesëmarrjen e grave në procesin e zhvillimit të buxhetit.

## 1. HYRJE

Në mbështetje të zhvillimit të mëtejshëm të demokracisë së qëndrueshme dhe llogaridhënëse në Kosovë, OSBE-ja synon të risë kapacitetet e kuvendeve komunale dhe komiteteve të tyre për të monitoruar zbatimin e politikave lokale, përmirësimin e kapaciteteve legjislative dhe operacionale të qeverive lokale dhe të shtojë angazhimet komunale për përfshirje të publikut në proceset vendimmarrëse. Në ndjekje të këtyre objektivave, ekipet e terrenit të OSBE-së kryejnë aktivitete vjetore monitoruese të përputhshmërisë komunale me kornizën ligjore për zhvillim buxhetor, në veçanti respektimin e afateve për miratimin e buxheteve dhe kërkesat për konsultime publike.<sup>1</sup>

Ky raport i paraqet zhvillimet e vërejtura në respektim të kornizës ligjore për përgatitjen dhe miratimin e buxheteve komunale për vitin fiskal 2013 nga komunat e Kosovës. Përmes krahasimit të përputhshmërisë me kornizën ligjore (buxhetet komunale të 2012 kundrejt atyre të 2013)<sup>2</sup>, janë identifikuar fushat në nevojë për përmirësime dhe përkrahje të mëtejme. Të dhënat për këtë raport janë mbledhur nga monitorimi dhe aktivitetet raportuese të ekipeve të OSBE-së në terren në 34 komuna<sup>3</sup> nga muaji maj e deri në tetor 2012.<sup>4</sup> OSBE-ja ka dizajnuar një vegël për të ndjekur pjesëmarrjen e publikut në çdo takim të kuvendeve komunale, komitete për politika dhe financa dhe takime të komiteteve për komunitete në të cilat pikë e rendit të ditës ishte zhvillimi i buxhetit komunal, si dhe takimet publike të ftuara për të diskutuar buxhetin e 2013.<sup>5</sup> 74 takime të kuvendeve komunale, 69 takime të komiteteve për politikë dhe financa, 7 takime të komiteteve për komunitete dhe afërsisht 180 takime publike janë monitoruar në mënyrë të njëjtë duke e shfrytëzuar këtë vegël. Veç kësaj, të dhënat që lidhen me respektimin nga komunat të afateve të detyrueshme kohore për përgatitje të buxheteve janë mbledhur drejtpërdrejt nga zyrtarët gjegjës komunalë. Informacionet nga Ministria e Financave janë gjithashtu pjesë e këtij raporti.

Ashtu si raporti pararendës në të njëjtën temë, ky raport shërben si vegël për hisedarët, në veçanti komunat, ministrinë e linjës dhe organizatat e shoqërisë civile për të formuluar strategji për përmirësimin e përputhshmërisë komunale me kërkesat ligjore të procesit të zhvillimit të buxhetit komunal nëpër komuna. Prandaj, karshi sfondit të dispozitave ligjore relevante lidhur me përgatitjen dhe miratimin e buxheteve komunale vjetore, ai ofron analizë kuantitative dhe kualitative të përputhshmërisë komunale me dispozitat ligjore në krahasim me vitin e kaluar fiskal, duke i kushtuar vëmendje të veçantë afateve të miratimit të buxhetit dhe kërkesave për konsultim publik, si dhe shkallës së pjesëmarrjes së publikut në procesin e zhvillimit buxhetor. Raporti ofron një seri rekomandimesh shtesë për veprime korrigjuese për ministrinë e linjës dhe komunat. Një pasqyrë e përgjithshme e disa aktiviteteve kryesore të OSBE-së të organizuara në përkrahje të procesit të zhvillimit të buxheteve komunale për 2013 i është bashkëngjitur në fund këtij raporti si shtojcë.

<sup>1</sup> Për qëllim të këtij raporti, OSBE-ja ka shqyrtuar vetëm *procesin* e miratimit të buxheteve komunale, e jo kategoritë/ndarjet brenda një propozim-buxheti komunal të caktuar.

<sup>2</sup> Vëreni ju lutem: Çfarëdo buxheti komunal aktual përgatitet gjatë vitit të kaluar fiskal. Ky raport analizon procesin e miratimit e buxheteve komunale të vitit 2012 dhe 2013, të cilat janë përgatitur në vitin 2011, përkatësisht 2012.

<sup>3</sup> Komunat në veri të Lumit Ibër nuk janë përfshirë në këtë vlerësim.

<sup>4</sup> Gjetjet nga raporti i kaluar janë publikuar dhe u janë shpërndarë të gjithë zyrtarëve gjegjës komunalë dhe të ministrisë, organizatave të shoqërisë civile, si dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Shih Raportin e OSBE-së *Procesi i zhvillimit të buxheteve në komunat e Kosovës i 2012: Vlerësim* (maj 2012) linku

<sup>5</sup> Vegla e përcjelljes ka regjistruar informacione në pjesëmarrjen numerike dhe cilësore të banorëve në takimet e lartpërmendura, si dhe njoftimet publike për pjesëmarrje në të tilla takime dhe kushtet për pjesëmarrje publike.

## 2. PROCEDURAT PËR PËRGATITJEN DHE MIRATIMIN E BUXHETEVE VJETORE KOMUNALE

Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë i përcakton kërkesat kyçe që duhet të respektohen gjatë zhvillimit dhe miratimit të buxheteve komunale çdo vjet, derisa hapat specifike shtjellohen më tej në Qarkore buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave.<sup>6</sup> Si dega e ekzekutivit ashtu dhe ajo e legjislativit të strukturave të qeverive komunale kanë detyra dhe përgjegjësi ligjore karshi zhvillimit të buxheteve komunale vjetore. Nga ana e ekzekutivit, kryetari i komunës është përgjegjës që t’ia propozojë projekt-buxhetin komunal kuvendit komunal për miratim, si dhe për ekzekutimin e tij pas miratimit.<sup>7</sup> Nga ana e legjislativit, komiteti për politika dhe financa, komitet i obligueshëm i çdo kuvendi komunal,<sup>8</sup> është përgjegjës, mes tjerash, për shqyrtimin e kornizës afatmesme buxhetore dhe projekt-buxhetin e propozuar.<sup>9</sup> Që të dy këto dokumente më pas duhet të miratohen nga kuvendi komunal, organi më i lartë përfaqësues i komunës.<sup>10</sup> Për më tepër, ndonëse legjislacioni i lidhur me buxhetin nuk i cakton komiteteve për komunitete rol të qartë shqyrtues apo miratues të dokumenteve të lartpërmendura, komiteti ka mandat t’i shqyrtojë të gjitha politikatat, praktikatat dhe aktivitetet komunale për të siguruar respektimin<sup>11</sup> e të drejtave të komuniteteve joshumicë.<sup>12</sup>

Sa i përket konsultimit publik, Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Qarkorja buxhetore specifikojnë se çfarë forma të konsultimit publik duhet të ndodhin gjatë procesit të zhvillimit të buxhetit. Qëllimi i konsultimit publik është që të kontribuojë në formulimin e buxheteve komunale që reflektojnë nevojat dhe prioritetet e banorëve, si dhe përkushtimin komunal ndaj parimeve të qeverisjes së mirë të transparencës dhe llogaridhënies.<sup>13</sup>

Ndonëse nuk janë bërë ndryshime relevante në Ligjin për menaxhim të financave publike dhe përgjegjësitë për procesin e zhvillimit buxhetor të 2013,<sup>14</sup> Qarkorja e buxhetit komunal 2013/01,<sup>15</sup> përmban dy ndryshime nga viti i kaluar:

---

<sup>6</sup> Për përshkrim të hollësishëm të kornizës ligjore, shih: OSBE Raporti i 2012 *Procesi i Zhvillimit Buxhetor në Komunitet e Kosovës: Vlerësim* (maj 2012).

<sup>7</sup> Neni 58, Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, 4 qershor 2008.

<sup>8</sup> Neni 52.1, Po aty. Komiteti për politika dhe financa kryesohet nga kryesuesi i kuvendit komunal dhe përbërja e tij reflekton partitë/subjektet politike të përfaqësuara në kuvend komunal.

<sup>9</sup> Neni 52.2, Ligji për vetëqeverisje lokale.

<sup>10</sup> Neni 35.1, Po aty.

<sup>11</sup> Neni 53, Ligji për vetëqeverisje lokale.

<sup>12</sup> Për qëllim të këtij raporti, fjala joshumicë i referohet çdo komuniteti që është pakicë numerike në cilëndo komunë.

<sup>13</sup> Referencat ligjore për kërkesat për konsultime publike të paraqitura në Figurën 1: *Konsultimet me komunitetet dhe hisedarët kyç; komiteti për politika dhe financa mbanë takime publike; kryetari i komunës ia paraqet Kornizën afatmesme buxhetore kuvendit komunal për diskutim* – faqe 16, Qarkore për buxhetin komunal 2013/01, 11 maj 2012. *Zyrtari i lartë financiar, në konsultim me kryetarin e komunës, zhvillon takime publike* – faqe 17, Qarkore për buxhetin komunal 2013/01, 11 maj 2012. Kuvendi komunal mbanë së paku një takim publik – Neni 61.2, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, 3 qershor 2008.


<sup>14</sup> Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë është në programin legjislativ të Kuvendit të Kosovës për vitin 2013.

<sup>15</sup> Lëshuar më 11 maj 2012 nga Ministria e Financave.

1. Data deri kur kuvendi komunal do të duhej ta kishte miratuar Kornizën afatmesme buxhetore dhe dorëzuar një kopje të saj në Ministrinë e Financave është zgjatur nga 30 qershori, sa ishte më parë, deri më 30 korrik.<sup>16</sup>
2. Kërkesë e qartë për kryetarin e komunës për të dorëzuar kornizën afatmesme buxhetore “në kuvendin komunal për diskutim publik”<sup>17</sup>

Figura 1 ilustron hapat kryesorë dhe kërkesat për konsultime publike të procesit të përgatitjes dhe miratimit të buxhetit vjetor.<sup>18</sup>

Figura 1: Afatet që lidhen me zhvillimin e buxhetit vjetor komunal dhe kërkesat për konsultime publike<sup>19</sup>



Korniza ligjore siguron hollësi se si komunat duhet t'i informojnë banorët për takimet e rregullta të kuvendeve komunale dhe komiteteve, si dhe për takimet publike.<sup>20</sup> Për takimet e rregullta të kuvendit komunal dhe komiteteve të tij, duhet të bëhet njoftim publik shtatë ditë para mbajtjes së takimit<sup>21</sup> dhe të jetë në përputhshmëri me ligjin për gjuhët.<sup>22</sup>

<sup>16</sup> Faqe 6, Qarkortja për Buxhet Komunal 2013/01, 11 maj 2012.

<sup>17</sup> Faqe 16, Po aty.

<sup>18</sup> Disa hapa të brendshme komunale për përgatitje të buxhetit, siç është përgatitja e shqyrtimit të prioriteteve programore komunale, vendosja e kufijve fillestarë për programe specifike dhe nxjerrja e qarkoreve të brendshme buxhetore komunale nuk shqyrtohen në këtë raport.

<sup>19</sup> Referencat ligjore për afatet të paraqitura në Figurën 1: afati i 15 majit – Neni 6.2, Ligji Nr. 03/L-221 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Afati i 30 korrikut – Faqe 6, Qarkortja buxhetore komunale 2013/01, 11 maj 2012. Afati i 1 shtatorit – Neni 61.1, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, 3 qershor 2008. Afati i 30 shtatorit – Nenet 20.3 dhe 61.3, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, 3 qershor 2008.

<sup>20</sup> Neni 45, Ligji për vetëqeverisje lokale, plotësuar nga neni 3 i Udhëzimi 2008/09 për transparencë në komuna i Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, thotë që takimet e kuvendeve komunale dhe komiteteve të tyre janë të hapura për publikun. Anëtarë të publikut lejohen të ndjekin dhe marrin pjesë në takimet e kuvendeve komunale sipas rregulloreve të punës të komunave. Në fakt, takimet e rregullta dhe jashtëzakonshme të kuvendeve komunale dhe komiteteve të tyre janë të hapura për publikun përveç nëse merren veprime specifike, më saktësisht votimi i shumicës së kuvendit ose komitetit, për të mos lejuar praninë e publikut bazuar në brenga të sigurisë ose të privatësisë.

<sup>21</sup> Neni 43.3, Ligji për vetëqeverisje lokale. Njoftimi duhet gjithashtu të përmbajë informacione për datën, kohën, vendin e takimit dhe rendin e ditës dhe çfarëdo materiale tjera që ndërlidhen me takim. Gjithashtu, takimet e jashtëzakonshme të organit legjislativ duhet t'i respektojnë të njëjtat kërkesa procedurale për njoftim, por në këtë rast kërkohet njoftim paraprak vetëm 3 ditë më parë (po aty, neni 44.4).

<sup>22</sup> Neni 43.4, Ligji për vetëqeverisje lokale. Neni 7.3, Ligji Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, “Gjuhët zyrtare përdoren në baza të barabarta në takimet dhe në punën e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive

Njoftimi publik duhet të vendoset në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës dhe të vendoset në faqen zyrtare komunale të internetit si dhe në media të shkruara dhe elektronike.<sup>23</sup> Për më tepër kryesuesi i kuvendit komunal apo komitetit është përgjegjës për të siguruar që kushtet fizike të vendit të takimit janë adekuate për pjesëmarrjen e publikut.<sup>24</sup> Për takimet publike tjera nga takimet e organeve legjislative, vlejné kriteret e njëjta të njoftimit, por me njoftim paraprak dy javor.<sup>25</sup>

### 3. ANALIZË KRAHASUESE E RESPEKTIMIT TË KËRKESAVE PËR ZHVILLIMIN E BUXHETIT NGA KOMUNAT PËR BUXHETIN E VITIT 2012 DHE 2013

#### 3.1 Respektimi i afateve për zhvillimin e procesit buxhetor

Siç është përshkruar në pjesën e mëparshme, komunat duhet të dorëzojnë dy dokumente kryesore të buxhetit në Ministrinë e Financave. Dokumenti i parë, korniza afatmesme buxhetore, duhet të miratohet nga komiteti për politika dhe financa dhe kuvendi komunal dhe t'i dorëzohet Ministrisë së Financave deri më 30 korrik. Kryetari i Komunës duhet ta paraqesë dokumentin e dytë, propozim-buxhetin, në kuvendin komunal deri më 1 shtator. Propozim buxheti pas shqyrtimit dhe ndryshim/plotësimit duhet të miratohet nga komiteti për politika dhe financa dhe kuvendi komunal dhe të dorëzohet në Ministri deri më 30 shtator.<sup>26</sup> Tabela 1 paraqet informata lidhur me respektimin e këtyre afateve nga komunat gjatë procesit buxhetor të komunave për vitin 2012 dhe 2013:

<i>TABELA 1: Respektimi i afateve që ndërlidhen me buxhetin</i>	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2012) (%)</b>	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2013) (%)</b>
<b>Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore</b>		
Miratimi nga kuvendi komunal brenda afatit	47 <sup>27</sup>	62 <sup>28</sup>
Miratimi nga kuvendi komunal pas afatit	47 <sup>29</sup>	35 <sup>30</sup>

komunale. Institucionet komunale do të mundësojnë përkthimin nga një gjuhë zyrtare në tjetrën, nëse kjo kërkohet, në takimet e këtyre organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale, po ashtu edhe në takimet publike të organizuara nga komuna.

<sup>23</sup> Neni 3.3, Udhëzimi Administrativ nr. 2008/09 për transparencë në komuna, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, 15 korrik 2008.

<sup>24</sup> “Kryesuesi i kuvendit komunal apo i takimeve përkatëse të komiteteve siguron që kushtet dhe mundësitë fizike për pjesëmarrjen e publikut janë ofruar në vendin ku do të mbahet takimi.”, Neni 3.2 Po aty.

<sup>25</sup> Neni 68.1, Ligji për vetëqeverisje lokale, neni 6.4, Udhëzimi administrativ për transparencë nëpër komuna, Ministria e administrimit të pushtetit lokal.

<sup>26</sup> Misioni ka mbledhur informata si për datën e miratimit të propozim buxhetit nga komitetet për politikë dhe financa ashtu edhe nga kuvendet komunale si dhe për datën e dorëzimit dhe/apo pranimit të dokumenteve në Ministrinë e financave. Për qëllim të qartësisimit, data e miratimit është në fokus të gjetjeve të monitorimit, pasi që pranimi nga Ministria mund të vonohet për shkaqe të ndryshme logjistike dhe organizative.

<sup>27</sup> 16 komuna: Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Glllogoc/Glogovac, Hani i Elezit/Elez Han, Kamenicë/Kamenica, Klokot/Klllokot, Lipjan/Lipljan, Mamuşa/Mamushë/Mamuşa, Mitrovicë/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërde, Ranilug/Ranillug, Shtime/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Štrpce/Shtërpçë, Suharekë/Suva Reka, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>28</sup> Njëzet e një komuna: Deçan/Deçane, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Glllogoc/Glogovac, Gračanica/Graçanicë, Hani i Elezit/Elez Han, Istog/Istok, Klinë/Klina, Klokot/Klllokot, Lipjan/Lipljan, Malishevë/Mališevo, Mamuşa/Mamushë/Mamuşa, Mitrovicë/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërde, Ranilug/Ranillug, Shtime/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Štrpce/Shtërpçë, Suharekë/Suva Reka, Vushtrri/Vučitrn.

Mos miratim nga kuvendi komunal	6 <sup>31</sup>	3 <sup>32</sup>
Të dorëzuara në Ministri të Financave pa miratim paraprak ose para miratimit nga kuvendi komunal	35 <sup>33</sup>	21 <sup>34</sup>
Rastet ku nuk ka pasur miratim nga komiteti për politika dhe financa	12 <sup>35</sup>	9 <sup>36</sup>
<b>Miratimi i propozim buxhetit</b>		
Miratimi nga kuvendi komunal brenda afatit	100	97 <sup>37</sup>
Miratim nga kuvendi komunal pas afatit	0	3 <sup>38</sup>
Rastet ku nuk ka pasur miratim nga komiteti për politika dhe financa	6 <sup>39</sup>	0
<b>Dorëzimi i propozim buxhetit të legjislativi</b>		
Kryetari i komunës e ka dorëzuar atë brenda afatit	38 <sup>40</sup>	38 <sup>41</sup>
<b>Respektimi i që të tri afateve</b>	21 <sup>42</sup>	29 <sup>43</sup>

Janë vërejtur këto përmirësime nga procesi i zhvillimit të buxhetit i vitit 2012 në atë të vitit 2013:

- Pesë kuvende tjera komunale e kanë miratuar kornizën afatmesme të buxhetit 2013 – 2015 brenda afatit kohor në krahasim me atë të vitit 2012 – 2014.
- Në krahasim me vitin 2012, tri komuna më pak e kanë dorëzuar kornizën afatmesme buxhetore për vitin 2013 në Ministrinë e Financave para miratimit apo pa miratimin nga kuvendi komunal.
- Miratimi nga komiteti për financa i propozim buxhetit të vitit 2013 nuk është anashkaluar nga asnjë komunë derisa kjo kishte ndodhur në dy raste gjatë procesit të buxhetit komunal në vitin 2012.

<sup>29</sup> Gjashtëmbëdhjetë komuna: Deçan/Deçane, Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Gjakovë/Đakovica, Gračanica/Gračanicë, Istog/Istok, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Malishevë/Mališevo, Obiliq/Obilić, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Prizren, Rahovec/Orahovac, Viti/Vitina.

<sup>30</sup> Dymbëdhjetë komuna: Dragash/Dragaš, Gjakovë/Đakovica, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Obiliq/Obilić, Parteš/Partesh, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Prizren, Rahovec/Orahovac, Viti/Vitina.

<sup>31</sup> Dy komuna: Klinë/Klina, Parteš/Partesh.

<sup>32</sup> Vetëm Podujeva/Podujevo.

<sup>33</sup> Dymbëdhjetë komuna: Deçan/Deçane, Dragash/Dragaš, Gjakovë/Đakovica, Gračanica/Gračanicë, Istog/Istok, Junik, Klinë/Klina, Malishevë/Mališevo, Parteš/Partesh, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Viti/Vitina,

<sup>34</sup> Shtatë komuna: Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gračanica/Gračanicë, Junik, Obiliq/Obilić, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prizren.

<sup>35</sup> Katër komuna: Gjiilan/Gnjilane, Parteš/Partesh, Ranilug/Ranillug, Shtime/Štimlje.

<sup>36</sup> Tre komuna: Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Malishevë/Mališevo, Štrpce/Shtërpçë. Mirëpo në Parteš/Partesh, korniza afatmesme buxhetore është miratuar në nëntor pas kërkesës nga Ministria e Financave.

<sup>37</sup> Jo në Viti/Vitina.

<sup>38</sup> Viti/Vitina.

<sup>39</sup> Dy komuna: Shtime/Štimlje, Štrpce/Shtërpçë.

<sup>40</sup> Trembëdhjetë komuna: Deçan/Deçane, Gjakovë/Đakovica, Gjiilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Hani i Elezit/Elez Han, Istog/Istok, Klinë/Klina, Lipjan/Lipljan, Malishevë/Mališevo, Mitrovicë/Mitrovica, Podujevë/Podujevo, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>41</sup> Trembëdhjetë komuna: Ferizaj/Uroševac, Gjiilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Istog/Istok, Junik, Klinë/Klina, Klokot/Kllokot, Mitrovicë/Mitrovica, Parteš/Partesh, Pejë/Peć, Skenderaj/Srbica, Štrpce/Shtërpçë, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>42</sup> Shtatë komuna: Gjiilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Hani i Elezit/Elez Han, Lipjan/Lipljan, Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>43</sup> Dhjetë komuna: Ferizaj/Uroševac, Gjiilan/Gnjilane, Klokot/Kllokot, Štrpce/Shtërpçë (ndonëse miratimi i Kornizës afatmesme buxhetore i komitetit për politika dhe financa ishte anashkaluar) Glogoc/Glogovac, Mitrovicë/Mitrovica, Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Istog/Istok, Klinë/Klina.



- Numri i komunave që i kanë respektuar që të tri afatet për përgatitjen e buxheteve komunale për vitin 2013 është rritur me tre në krahasim me përgatitjen e buxhetit për vitin 2012.

Ka pasur pas ose aspak përmirësime në fushat si në vijim:

- Vetëm një komunë më pak e kishte anashkaluar miratimin nga komiteti për politika dhe financa të kornizës afatmesme të buxhetit.
- Një komunë nuk e kishte miratuar propozim buxhetin e vitit 2013 brenda afatit në krahasim me vitin 2012 ku nuk kishte asnjë.
- Numri i komunave ku kryetari i komunës e kishte respektuar afatin e një shtatorit për dorëzimin e propozim buxhetit në kuvendin komunal ka mbetur i njëjtte si në procesin e buxheteve komunale të vitit 2013.

### 3.2 Takimet e organeve legjislative komunale për zhvillimin e buxhetit

#### 3.2.1 Pasqyrim i takimeve të organeve legjislative për zhvillim të buxhetit komunal

Tabela 2 paraqet informata përkitazi me numrin e takimeve të mbajtura nga kuvendet komunale, komitetet për politika dhe financa, dhe komitetet për komunitete për rishikimin dhe/apo miratimin e kornizës afatmesme buxhetore apo propozim buxhetit, apo për të diskutuar përkitazi me përgatitjen e buxhetit në përgjithësi:

<i>TABELA 2: Pasqyrim i takimeve të organeve legjislative të mbajtura për rishikim/miratim të buxhetit</i>	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2012)</b> (%)	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2013)</b> (%)
1 takim të kuvendit komunal	26 <sup>44</sup>	12 <sup>45</sup>
2 takime të kuvendit komunal	71 <sup>46</sup>	62 <sup>47</sup>
3+ takime të kuvendit komunal	3 <sup>48</sup>	26 <sup>49</sup>
1 takim të komitetit për politikë dhe financa	35 <sup>50</sup>	21 <sup>51</sup>
2 takime të komitetit për politikë dhe financa	59 <sup>52</sup>	59 <sup>53</sup>

<sup>44</sup> Nëntë komuna: Gjakovë/Đakovica, Istog/Istok, Junik, Klinë/Klina, Malishevë/Mališevo, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Prizren, Rahovec/Orahovac.

<sup>45</sup> Katër komuna: Dragash/Dragaš, Gjakovë/Đakovica, Prishtinë/Priština, Rahovec/Orahovac.

<sup>46</sup> Njëzetë e katër komuna: Deçan/Dečane, Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Gračanica/Gračanicë, Hani i Elezit/Elez Han, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klokot/Kllokot, Lipjan/Lipljan, Mamuşa/Mamushë/Mamuşa, Mitrovicë/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërde, Obiliq/Obilić, Parteş/Partesh, Podujevë/Podujevo, Ranilug/Ranillug, Shtime/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Suharekë/Suva Reka, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>47</sup> Njëzetë e një komuna: Deçan/Dečane, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Hani i Elezit/Elez Han, Istog/Istok, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klokot/Kllokot, Lipjan/Lipljan, Malishevë/Mališevo, Mamuşa/Mamushë/Mamuşa, Parteş/Partesh, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Ranilug/Ranillug, Skenderaj/Srbica, Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina.

<sup>48</sup> Štrpce/Shtërpçë.

<sup>49</sup> Nëntë komuna: Gračanica/Gračanicë, Klinë/Klina, Mitrovicë/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërde, Obiliq/Obilić, Prizren, Shtime/Štimlje, Suharekë/Suva Reka, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>50</sup> Dymbëdhjetë komuna: Gjakovë/Đakovica, Gjilan/Gnjilane, Gračanica/Gračanicë, Istog/Istok, Malishevë/Mališevo, Parteş/Partesh, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Prizren, Rahovec/Orahovac, Ranilug/Ranillug, Štrpce/Shtërpçë.

<sup>51</sup> Shtatë komuna: Dragash/Dragaš, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjakovë/Đakovica, Malishevë/Mališevo, Prishtinë/Priština, Rahovec/Orahovac, Štrpce/Shtërpçë.

<sup>52</sup> Njëzetë komuna: Dragash/Dragaš, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Glogoc/Glogovac, Hani i Elezit/Elez Han, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Klokot/Kllokot, Lipjan/Lipljan,

3+ takime të komitetit për politika dhe financa	6 <sup>54</sup>	21 <sup>55</sup>
1+ apo më tepër takime të komitetit për komunitete	21 <sup>56</sup>	18 <sup>57</sup>

Ashtu si në procesin e mëparshëm të zhvillimit të buxhetit, shumica e komiteteve për politika dhe financa dhe e kuvendeve komunale i kanë mbajtur saktësisht nga dy takime për buxhetin e vitit 2013 – në përgjithësi, një takim ku është miratuar korniza afatmesme buxhetore dhe një tjetër ku është miratuar propozim buxheti. Për ato komuna ku komiteti për politikë dhe financa është takuar vetëm një herë gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit, nuk është kërkuar miratimi nga ky komitet i asnjërit nga këto dy dokumente, komiteti i ka miratuar që të dy dokumentet në një takim, apo që të dy dokumentet janë miratuar në “pako”. Ngjashëm me këtë, kuvendet komunale që janë mbledhur vetëm një herë i kanë miratuar që të dy dokumentet në të njëjtën ditë në “pako”. Një praktikë e tillë jo vetëm që është në kundërshtim me procedurat e parapara në kornizën ligjore, por ajo e vë në pikëpyetje masën deri në të cilën këto organe legjislative i diskutojnë në mënyrë të thukët prioritetet e shpenzimeve.

Nga një këndvështrim më pozitiv, numri i komunave në të cilat komiteti për financa dhe kuvendi komunal është mbledhur vetëm një herë për t’i rishikuar dhe miratuar dokumentet buxhetore për vitin 2013 ka rënë. Mirëpo, numri i komiteteve për komunitete që i kanë shqyrtuar njërin nga dy dokumentet nuk ka shënuar rritje.

### 3.2.2 Njoftimi publik për takimet e organeve legjislative lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal

Tabela 3 dhe 4 paraqesin të dhëna lidhur me takimet e kuvendeve komunale, komiteteve për politika dhe financa dhe komitetet për komunitete për rishikimin dhe/apo miratimin e buxheteve për rishikimin dhe/apo miratimin e buxheteve për vitin 2012 dhe 2013:

<i>TABELA 3: Njoftimi publik për takimet e organeve legjislative lidhur me zhvillimin e buxhetit I</i>	<b>Përqindja e të gjitha takimeve (buxheti 2012)</b>	<b>Përqindja e të gjitha takimeve (buxheti 2013)</b>
Takimet e kuvendit komunal të shpallura publikisht 7+ ditë para takimit	85%	85%
Takimet e komitetit për financa të shpallura publikisht 7+ ditë para takimit	59%	68%
Takimet e komitetit për komunitete të shpallura publikisht 7+ ditë para takimit	38% (3 nga 8)	43% (3 nga 7)

Mamuša/Mamushë/Mamuša, Mitrovicë/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërde, Obiliq/Obilić, Podujevë/Podujevo, Shtime/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Suharekë/Suva Reka, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>53</sup> Njëzetë komuna: Deçan/Dečane, Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Gračanica/Gračanicë, Hani i Elezit/Ellez Han, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klokot/Kllokot, Obiliq/Obilić, Parteš/Partesh, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prizren, Ranilug/Ranillug, Skenderaj/Srbica, Suharekë/Suva Reka, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>54</sup> Dy komuna: Deçan/Dečane and Ferizaj/Uroševac.

<sup>55</sup> Shtatë komuna: Istog/Istok, Klinë/Klina, Lipjan/Lipljan, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Mitrovicë/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërde, Shtime/Štimlje.

<sup>56</sup> Shtatë komuna: Dragash/Dragaš, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gračanica/Gračanicë, Hani i Elezit/Ellez Han, Lipjan/Lipljan, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Suharekë/Suva Reka.

<sup>57</sup> Gjashtë komuna: Dragash/Dragaš, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Hani i Elezit/Ellez Han, Klinë/Klina, Lipjan/Lipljan, Mamuša/Mamushë/Mamuša.

<b>TABELA 4: Njoftimi publik i takimeve të organeve legjislative lidhur me zhvillimin e buxhetit II</b>	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2012) (%)</b>	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2013) (%)</b>
<b>Takimet e kuvendit komunal</b>		
Kanë dështuar që të shpallin publikisht lise më shumë takime	9 <sup>58</sup>	3 <sup>59</sup>
Çdo takim është shpallur publikisht në gjuhët zyrtare	29 <sup>60</sup>	32 <sup>61</sup>
<b>Takimet e komitetit për politika dhe financa</b>		
Kanë dështuar që të shpallin publikisht lise më shumë takime	32 <sup>62</sup>	21 <sup>63</sup>
Çdo takim është shpallur publikisht në gjuhët zyrtare	32 <sup>64</sup>	26 <sup>65</sup>
<b>Takimet e komitetit për komunitete</b>		
Kanë dështuar që të shpallin publikisht lise më shumë takime	9 <sup>66</sup>	12 <sup>67</sup>
Çdo takim është shpallur publikisht në gjuhët zyrtare	3 <sup>68</sup>	3 <sup>69</sup>

Në këtë aspekt, është vërejtur përparim minimal gjatë përgatitjeve për buxhet komunal të vitit 2013 në krahasim me vitin 2012:

- Më shumë takime të komiteve për politika dhe financa janë lajmëruar shtatë apo më shumë ditë para takimeve.
- Më pak komuna kanë dështuar që të bëjnë njoftimet publike për një apo më tepër takime të kuvendeve komunale apo komiteve për politika dhe financa për zhvillim të buxhetit.

Format më të shpeshta të njoftimit publik për takimet e organeve kryesore legjislative mbesin të njëjta si në procesin buxhetor të vitit 2012 – njoftimi në faqet e internetit të komunave, njoftimet (përmes fletushkave dhe/apo afisheve) e vendosura në ndërtesat komunale dhe apo tabelat publike të informimit, apo kombinim i tyre. Format tjera të njoftimit publik që përdoren nga komunat përfshijnë vendosjen e njoftimeve (fletushkave dhe/apo afisheve) në

<sup>58</sup> Tre komuna: Gjakovë/Đakovica, Klokot/Klllokot, Štrpce/Shtërpçë.

<sup>59</sup> Suharekë/Suva Reka; mirëpo kjo ka qenë seancë e jashtëzakonshme e kuvendit komunal, që do të kishte kërkuar njoftim paraprak prej tri ditësh.

<sup>60</sup> Dhjetë komuna: Dragash/Dragaš, Gjilan/Gnjilane, Klinë/Klina, Klokot/Klllokot, Pejë/Peć, Novo Brdo/Novobërdë, Prizren, Ranilug/Ranillug, Štrpce/Shtërpçë, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>61</sup> Njëmbëdhjetë komuna: Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Gračanica/Gračanicë, Kamenicë/Kamenica, Klokot/Klllokot, Novo Brdo/Novobërde, Partesh/Partesh, Prizren, Ranilug/Ranillug, Štrpce/Shtërpçë.

<sup>62</sup> Njëmbëdhjetë komuna: Deçan/Dečane, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Glllogoc/Glogovac, Istog/Istok, Junik, Klokot/Klllokot, Lipjan/Lipljan, Skenderaj/Srbica, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>63</sup> Shtatë komuna: Gjakovë/Đakovica, Deçan/Dečane, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Junik, Prizren, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>64</sup> Njëmbëdhjetë komuna: Dragash/Dragaš, Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Klokot/Klllokot, Lipjan/Lipljan, Novo Brdo/Novobërde, Pejë/Peć, Prizren, Ranilug/Ranillug, Štrpce/Shtërpçë.

<sup>65</sup> Nëntë komuna: Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Gračanica/Gračanicë, Kamenicë/Kamenica, Klokot/Klllokot, Novo Brdo/Novobërde, Partesh/Partesh, Ranilug/Ranillug, Štrpce/Shtërpçë.

<sup>66</sup> Nga tetë tetë komuna që i kishin thirrur takimet e komitetit për komunitete, tre kishin dështuar që të bëjnë njoftime publike për një apo më shumë takime: Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gračanica/Gračanicë, Lipjan/Lipljan.

<sup>67</sup> Nga gjashtë komuna që kishin thirrur takime të komitetit për komunitete, katër kishin dështuar që të bëjnë njoftime publike të një apo më tepër takimeve: Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Hani i Elezit/Elez Han, Klinë/Klina, Lipjan/Lipljan.

<sup>68</sup> Dragash/Dragaš.

<sup>69</sup> Dragash/Dragaš.

vende publike, transmetimin e njoftimeve përmes radios, dhe dërgimin e ftesave drejtpërsëdrejti organizatave të shoqërisë civile dhe mediave. Njoftimet në radio janë përdorur më shpesh për lajmërimin e takimeve të organeve legislative në procesin buxhetor të vitit 2013 se sa për atë të vitit 2012.

### 3.2.3 Pjesëmarrja publike në takimet e organeve legislative për zhvillimin e buxhetit komunal

Tabela 5 ofron të dhëna për kushtet për pjesëmarrje publike, posaçërisht përshtatshmërinë e lokacionit dhe ofrimin e përkthimit me gojë, në takimet e organeve legislative për shqyrtimin dhe aprovimin e buxhetit.

<i>TABELA 5: Kushtet për pjesëmarrje publike në takimet e organeve legislative</i>	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2012) (%)</b>	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2013) (%)</b>
<b>Takimet e kuvendit komunal</b>		
Të gjitha takimet janë mbajtur në lokacione adekuate për pjesëmarrje publike	91 <sup>70</sup>	94 <sup>71</sup>
Përkthimi me gojë është ofruar në një apo më shumë takime	21 <sup>72</sup>	12 <sup>73</sup>
<b>Takimet e komisionit për politikë dhe financa</b>		
Të gjitha takimet janë mbajtur në lokacione adekuate për pjesëmarrje publike	71 <sup>74</sup>	68 <sup>75</sup>
Përkthimi me gojë është ofruar në një apo më shumë takime	12 <sup>76</sup>	21 <sup>77</sup>
<b>Takimet e komisionit për komunitete</b>		
Një apo më shumë takime janë mbajtur në lokacione jo adekuate për pjesëmarrje publike	Nuk ka të dhëna	9 <sup>78</sup>
Përkthimi me gojë është ofruar në një apo më shumë takime	12 <sup>79</sup>	12 <sup>80</sup>

Nuk janë vërejtur ndryshime të konsiderueshme në proceset e përgatitjes së buxhetit komunal nga viti 2012 në 2013 për sa i përket përshtatshmërisë së sallave për takime të kuvendeve komunale apo komisioneve për politika dhe financa për pjesëmarrje publike.

<sup>70</sup> Tridhjetenjë komuna: Të gjitha komunat përveç Glllogocit/Glogovac, Junikut, Ranilugut/Ranillug.

<sup>71</sup> Tridhjetedy komuna: Të gjitha komunat përveç Klokotit/Klllokot, Ranilugut/Ranillug.

<sup>72</sup> Shtatë komuna: Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gračanica/Graçanicë, Kamenicë/Kamenica, Klokot/Klllokot, Lipjan/Lipljan, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Ranilug/Ranillug.

<sup>73</sup> Katër komuna: Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Pejë/Peç, Prizren.

<sup>74</sup> Njëzetekatër komuna: Deçan/Deçane, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Gračanica/Graçanicë, Hani i Elezit/Elez Han, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Klokot/Klllokot, Malishevë/Mališevo, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Mitrovicë/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërde, Obiliq/Obilić, Parteš/Partesh, Prishtinë/Priština, Prizren, Rahovec/Orahovac, Ranilug/Ranillug, Shtime/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Štrpce/Shtërpçë, Suharekë/Suva Reka.

<sup>75</sup> Njëzetetë komuna: Ferizaj/Uroševac, Gjakovë/Đakovica, Gračanica/Graçanicë, Hani i Elezit/Elez Han, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Klokot/Klllokot, Malishevë/Mališevo, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Mitrovicë/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërde, Obiliq/Obilić, Parteš/Partesh, Pejë/Peç, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Prizren, Rahovec/Orahovac, Shtime/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Štrpce/Shtërpçë, Suharekë/Suva Reka.

<sup>76</sup> Katër komuna: Dragash/Dragaš, Gjilan/Gnjilane, Novo Brdo/Novobërde, Štrpce/Shtërpçë.

<sup>77</sup> Shtatë komuna: Dragash/Dragaš, Gračanica/Graçanicë, Kamenicë/Kamenica, Klokot/Klllokot, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Novo Brdo/Novobërde, Štrpce/Shtërpçë.

<sup>78</sup> Tre komuna: Dragash/Dragaš, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Mamuša/Mamushë/Mamuša.

<sup>79</sup> Katër komuna: Dragash/Dragaš, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan, Mamuša/Mamushë/Mamuša.

<sup>80</sup> Katër komuna: Dragash/Dragaš, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan, Mamuša/Mamushë/Mamuša.

Për buxhetin e vitit 2013, ofrimi i përkthimit me gojë ka ndodhur më rrallë sesa për takimet e kuvendit komunal dhe më shpesh për takimet e komisionit për politikë dhe financa sesa për buxhetin 2012. Megjithatë, përkthimi me gojë vazhdon të ofrohet në gati të gjitha rastet kur është kërkuar apo ofrohet pavarësisht kërkesave specifike.<sup>81</sup>

Tabela 6 paraqet shifrat për vijueshmërinë e pjesëtarëve të publikut, duke përfshirë përfaqësues të shoqërive civile, si dhe përfaqësues të mediave në takimet e organeve legislative për shqyrtimin dhe/apo aprovimin e buxhetit për vitin 2012 dhe 2013:

<i>TABELA 6: Pjesëmarrja publike në takimet e organeve legislative</i>	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2012) (%)</b>	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2013) (%)</b>
<b>Takimet e kuvendit komunal</b>		
Qytetarët e pranishëm në një apo më shumë takime	74 <sup>82</sup>	74 <sup>83</sup>
Shoqëria civile e pranishme në një apo më shumë takime	Nuk ka të dhëna	71 <sup>84</sup>
Mediat e pranishme në një apo më shumë takime	82 <sup>85</sup>	82 <sup>86</sup>
<b>Takimet e komisionit për politikë dhe financa</b>		
Qytetarët e pranishëm në një apo më shumë takime	26 <sup>87</sup>	35 <sup>88</sup>
Shoqëria civile e pranishme në një apo më shumë takime	n/a	29 <sup>89</sup>

<sup>81</sup> Neni 7.3, Ligji nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, “Gjuhët zyrtare përdoren në baza të barabarta në takimet dhe në punën e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale. Institucionet komunale do të mundësojnë përkthimin nga një gjuhë zyrtare në tjetrën, nëse kjo kërkohet, në takimet e këtyre organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale, po ashtu edhe në takimet publike të organizuara nga komuna.”

<sup>82</sup> Njëzetepesë komuna: Deçan/Deçane, Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Gjakovë/Đakovica, Gjilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Gračanica/Gračanicë, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Klinë/Klina, Lipjan/Lipljan, Malishevë/Mališevo, Mamuşa/Mamushë/Mamuşa, Mitrovicë/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërde, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Prizren, Rahovec/Orahovac, Ranilug/Ranillug, Shtime/Štimlje, Štrpce/Shtërpçë, Suharekë/Suva Reka, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>83</sup> Njëzetepesë komuna: Deçan/Deçane, Dragash/Dragaš, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Istog/Istok, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Klokot/Kllokot, Lipjan/Lipljan, Malishevë/Mališevo, Mamuşa/Mamushë/Mamuşa, Novo Brdo/Novobërde, Obiliq/Obilić, Parteš/Partesh, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Prizren, Rahovec/Orahovac, Shtimë/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Suharekë/Suva Reka.

<sup>84</sup> Njëzetekatër komuna: Deçan/Deçane, Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Istog/Istok, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klokot/Kllokot, Lipjan/Lipljan, Mamuşa/Mamushë/Mamuşa, Mitrovicë/Mitrovica, Obiliq/Obilić, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Prizren, Rahovec/Orahovac, Shtimë/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Suharekë/Suva Reka, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>85</sup> Njëzetetë komuna: Deçan/Deçane, Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Gjakovë/Đakovica, Gjilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Hani i Elezit/Elez Han, Istog/Istok, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Klokot/Kllokot, Lipjan/Lipljan, Malishevë/Mališevo, Mitrovicë/Mitrovica, Parteš/Partesh, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Prizren, Rahovec/Orahovac, Shtimë/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Štrpce/Shtërpçë, Suharekë/Suva Reka, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>86</sup> Njëzetetë komuna: Deçan/Deçane, Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjakovë/Đakovica, Gjilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Istog/Istok, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Klokot/Kllokot, Lipjan/Lipljan, Malishevë/Mališevo, Mitrovicë/Mitrovica, Obiliq/Obilić, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Prizren, Rahovec/Orahovac, Shtimë/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Štrpce/Shtërpçë, Suharekë/Suva Reka, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>87</sup> Nëntë komuna: Deçan/Deçane, Gjilan/Gnjilane, Hani i Elezit/Elez Han, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Lipjan/Lipljan, Prishtinë/Priština, Rahovec/Orahovac, Viti/Vitina.

<sup>88</sup> Dymbëdhjetë komuna: Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjakovë/Đakovica, Gjilan/Gnjilane, Kaçanik/Kaçanik, Lipjan/Lipljan, Mitrovicë/Mitrovica, Obiliq/Obilić, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Rahovec/Orahovac, Shtimë/Štimlje, Vushtrri/Vučitrn.

Mediat e pranishme në një apo më shumë takime	41 <sup>90</sup>	41 <sup>91</sup>
<b>Takimet e komisionit për komunitete</b>		
Qytetarët e pranishëm në një apo më shumë takime	0	6 <sup>92</sup>
Shoqëria civile e pranishme në një apo më shumë takime	0	6 <sup>93</sup>
Mediat e pranishme në një apo më shumë takime	0	0

Të dhënat tregojnë se nuk ka ndryshim madhor në lidhje me vijueshmërinë e publikut në takimet e organeve legjislative gjatë përgatitjes së buxhetit 2013 krahasuar me atë të buxhetit për vitin 2012. Ende ka vijueshmëri me shpeshësi më të madhe në takimet e kuvendit komunal sesa në takimet e komisionit për politikë dhe financa apo komisionit për komunitete.<sup>94</sup> Edhe kur pjesëtarët e publikut marrin pjesë në takime të këtyre organeve legjislative, shifrat tregojnë se ato kanë prirje të jenë të ulëta – prapë për procesin e zhvillimit të buxhetit të vitit 2013, për shumicën dërmuese të takimeve të komisionit për politikë dhe financa dhe kuvendit komunal në të cilin ishin të pranishëm qytetarët, vijueshmëria ishte më pak se pesë individë.

Prania e mediave në takimet e organeve legjislative mund të rrisë vetëdijen publike të vendimeve legjislative dhe sigurojë se zyrtarët e zgjedhur kanë një standard më të lartë të transparencës dhe llogaridhënies. Numri i komunave në të cilat mediat ishin të pranishme për një apo më shumë takime të kuvendit komunal apo takime të komisionit për politikë dhe financa ishte e njëjtë për përgatitjen e buxhetit 2012 dhe 2013.

Megjithatë, janë vërejtur disa zhvillime pozitive në procesin e zhvillimit të buxhetit 2013:

- Prania e qytetarëve në takimet e komisionit për komunitete është vërejtur në dy takime në një komunë, krahasuar me mosprani të plotë të qytetarëve gjatë zhvillimit të buxhetit 2012.<sup>95</sup>
- Në tri komuna, ndryshe nga procesi i mëhershëm buxhetor, qytetarët kanë vijuar së paku një takim të komisionit për politika dhe financa.

Në procesin e buxhetit 2013, OSBE-ja ka grumbulluar të dhëna për vijueshmërinë e organizatave të shoqërisë civile, siç janë grupet lokale të avokimit apo monitorimit, këshillave të veprimit lokalë rinorë dhe të organizatave të tjera, në takimet e tre organeve legjislative për shqyrtimin dhe aprovimin buxhetor. Tabela 6 tregon se përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile kanë vijuar takimet e kuvendit komunal dhe takimet e komisionit për politikë dhe financa në pak më pak komuna sesa përfaqësuesit e mediave.

<sup>89</sup> Dhjetë komuna: Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Kaçanik/Kaçanik, Lipjan/Lipljan, Obiliq/Obilić, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Prizren, Shtimë/Štimlje, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>90</sup> Katërbëdhjetë komuna: Deçan/Dečane, Gjakovë/Đakovica, Gjilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Hani i Elezit/Elez Han, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Malishevë/Mališevo, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Prizren, Rahovec/Orahovac, Viti/Vitina.

<sup>91</sup> Katërbëdhjetë komuna: Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Prizren, Rahovec/Orahovac, Shtimë/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Viti/Vitina.

<sup>92</sup> Dy komuna: Klinë/Klina, Lipjan/Lipljan.

<sup>93</sup> Dy komuna: Klinë/Klina, Lipjan/Lipljan.

<sup>94</sup> Kjo mund të jetë si pasojë e respektimit më të madh të kërkesave për njoftim publik për takimet e kuvendit komunal jo takimeve të komisioneve për politikë dhe financa, siç është përshkruar më lartë; gjithashtu, ka gjasa që interesimi publik në kuvendin komunal, si organi më i lartë përfaqësues në komunë, është më i lartë.

<sup>95</sup> Mamuša/Mamushë/Mamuša.

OSBE-ja gjithashtu ka përcjellë për herë të parë nëse janë ngritur shqetësime nga zyrtarët komunalë apo qytetarët lidhur me prioritetet gjinore të shpenzimeve komunale në takimet për zhvillimin e buxhetit. Këto shqetësime janë ngritur në tetë takime të kuvendit komunal në 18 për qind të komunave<sup>96</sup> dhe dy takime të komisionit për politikë dhe financa në 6 për qind të komunave.<sup>97</sup> Zakonisht të ngritura nga anëtarët femra të këtyre organeve, shqetësimet kryesisht kishin të bënin me kërkesat për ndarjen e fondeve për grupet e grave deputete apo zyrën komunale për barazi gjinore për zbatimin e projekteve për promovimin e barazisë gjinore.

### 3.3 Takimet publike për zhvillimin e buxhetit komunal

#### 3.3.1 Pasqyrë e takimeve publike për zhvillimin e buxhetit komunal

Ekipet në terren të OSBE-së kanë monitoruar dhe kanë raportuar për rreth 180 takime publike të thirrura për të diskutuar buxhetin e vitit 2013 dhe për të mbledhur informata publike për prioritetet e buxhetit.<sup>98</sup> Tabela 7 tregon se ka pasur më shumë komuna që kanë thirrur takime publike për të diskutuar buxhetin 2013 sesa buxhetin 2012:

<i>TABELA 7: Numri i takimeve publike të thirrura për zhvillimin e buxhetit</i>	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2012) (%)</b>	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2013) (%)</b>
<b>Gjithsej: 100 më 2011; 180 më 2012</b>		
1 – 2 takime të thirrura publike	47 <sup>99</sup>	35 <sup>100</sup>
3 – 4 takime të thirrura publike	24 <sup>101</sup>	18 <sup>102</sup>
5 – 7 takime të thirrura publike	24 <sup>103</sup>	26 <sup>104</sup>
8 – 11 takime të thirrura publike	0	18 <sup>105</sup>
15 takime të thirrura	3 <sup>106</sup>	0
32 takime të thirrura	0	3 <sup>107</sup>

<sup>96</sup> Gjashtë komuna: Në një takim në Deçan/Deçane, Malishevë/Mališevo, Pejë/Peć, Parteš/Partesh; në dy takime në Mitrovicë/Mitrovica dhe Suharekë/Suva Reka.

<sup>97</sup> Dy komuna: Deçan/Deçane, Parteš/Partesh.

<sup>98</sup> Duhet të theksohet se në shumë raste, akterë të jashtëm kanë ofruar mbështetje për komunat në organizimin e takimeve, siç është OSBE-ja; USAID Projekti për Komuna Demokratike Efektive, Nisma e realizuar nga Instituti Urban; Projekti i financuar nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim – Qeverisja lokale në Kosovë dhe mbështetja për decentralizim (LOGOS), zbatuar nga Helvetas Swiss-Inter-cooperation; dhe organizatat e shoqërisë civile në Kosovë.

<sup>99</sup> Gjashtëmbëdhjetë komuna: Dragash/Dragaš, Gjilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Hani i Elezit/Elez Han, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Malishevë/Mališevo, Obiliq/Obilić, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Skenderaj/Srbica, Štrpce/Shtërpçë, Suharekë/Suva Reka; Vushtri/Vučitrn.

<sup>100</sup> Dymbëdhjetë komuna: Dragash/Dragaš, Gjilan/Gnjilane, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klokot/Kllokot, Malishevë/Mališevo, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Obiliq/Obilić, Parteš/Partesh, Podujevë/Podujevo, Suharekë/Suva Reka.

<sup>101</sup> Tetë komuna: Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gračanica/Gračanicë, Klokot/Kllokot, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Novo Brdo/Novobërde, Parteš/Partesh, Ranilug/Ranillug, Shtimë/Štimlje.

<sup>102</sup> Gjashtë komuna: Deçan/Deçane, Gjakovë/Đakovica, Klinë/Klina, Ranilug/Ranillug, Skenderaj/Srbica; Pejë/Peć.

<sup>103</sup> Tetë komuna: Deçan/Deçane, Istog/Istok, Lipjan/Lipljan, Mitrovicë/Mitrovica, Prishtinë/Priština, Prizren, Rahovec/Orahovac, Viti/Vitina.

<sup>104</sup> Nëntë komuna: Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Glogoc/Glogovac, Hani i Elezit/Elez Han, Istog/Istok, Novo Brdo/Novobërde, Prishtinë/Priština; Shtimë/Štimlje; Štrpce/Shtërpçë.

<sup>105</sup> Gjashtë komuna: Gračanica/Gračanicë, Lipjan/Lipljan; Mitrovicë/Mitrovica, Prizren; Viti/Vitina; Vushtri/Vučitrn.

<sup>106</sup> Ferizaj/Uroševac.

<sup>107</sup> Rahovec/Orahovac.

0 takime publike	3 <sup>108</sup>	0
------------------	------------------	---

Siç është përshkruar në Pjesën 2, edhe organi komunal legjislativ edhe ekzekutiv kanë obligime për konsultime publike për buxhetin e vitit vijues fiskal. Tabela 8 paraqet informata lidhur me atë se cilat organe komunale kanë thirrur takime publike:

<b>TABELA 8: Takimet publike për zhvillimin e buxheteve të thirrura nga dega komunale e legjislativit dhe ekzekutivit</b>	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2012)</b>	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2013)</b>
Takimet publike të thirrura nga vetëm dega e ekzekutivit	53 <sup>109</sup>	64 <sup>110</sup>
Takimet publike të thirrura nga komisioni për politikë dhe financa	35 <sup>111</sup>	26 <sup>112</sup>
Takimet publike të thirrura nga kuvendi komunal	18 <sup>113</sup>	21 <sup>114</sup>
Takimet publike të thirrura nga kuvendi komunal pas pranimit të buxhetit nga kryetari i komunës	9 <sup>115</sup>	9 <sup>116</sup>

Ka një rritje në numrin e takimeve publike të thirrura vetëm nga dega e ekzekutivit. Kjo ka ndodhur në katër komuna më shumë.<sup>117</sup> Numri i kuvendeve komunale të cilat kanë thirrur takime publike është rritur për vetëm një. Është parë një mungesë e përparimit në fushat në vijim për procesin e buxhetit 2013 krahasuar me atë të buxhetit 2012. Numri i kuvendeve komunale që kanë përmbushur kërkesën ligjore për të thirrur një apo më shumë takime publike pas pranimit të propozim-buxhetit nga kryetari i komunës ka mbetur në tre. Ka rënie për sa i përket takimeve të komisionit për politikë dhe financa, ku kishte tri takime publike më pak gjatë procesit të buxhetit 2013.

Sikurse me përgatitjet për buxhetin komunal 2012, sekuenca e konsultimeve publike e përvijuar në Qarkoren Buxhetore – takimet publike për Kornizën afatmesme të shpenzimeve të thirrura nga dega e ekzekutivit, vijuar nga takimet publike për Kornizën afatmesme të shpenzimeve të thirrura nga komisioni për politikë dhe financa, pastaj takimet publike për propozimin e buxhetit të thirrura nga kuvendi komunal, vijuar nga takimet publike për propozimin e buxhetit të thirrura nga dega e ekzekutivit, dhe përmbyllur me takim publik për

<sup>108</sup> Gjakovë/Đakovica.

<sup>109</sup> Tetëmbëdhjetë komuna: Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Hani i Elezit/Elez Han, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Klinë/Klina, Klokot/Kllokot, Lipjan/Lipljan, Malishevë/Mališevo, Mitrovicë/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërde, Obiliq/Obilić, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Ranilug/Ranillug, Skenderaj/Srbica, Suharekë/Suva Reka, Viti/Vitina.

<sup>110</sup> Njëzetedy komuna: Dragash/Dragaš, Gjakovë/Đakovica, Glogoc/Glogovac, Hani i Elezit/Elez Han, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klokot/Kllokot, Lipjan/Lipljan, Malishevë/Mališevo, Mitrovicë/Mitrovica, Obiliq/Obilić, Partesh/Partesh, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Rahovec/Orahovac, Ranilug/Ranillug, Shtimë/Štimlje, Štrpce/Shtërpçë, Suharekë/Suva Reka, Viti/Vitina, Vushtri/Vučitrn.

<sup>111</sup> Dymbëdhjetë komuna: Deçan/Dečane, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Istog/Istok, Kamenicë/Kamenica, Mamuşa/Mamushë/Mamuša, Prizren, Rahovec/Orahovac, Shtimë/Štimlje, Štrpce/Shtërpçë, Vushtri/Vučitrn.

<sup>112</sup> Nëntë komuna: Deçan/Dečane, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Istog/Istok, Klinë/Klina, Mamuşa/Mamushë/Mamuša, Novo Brdo/Novobërde, Podujevë/Podujevo, Prizren.

<sup>113</sup> Gjashtë komuna: Deçan/Dečane, Gračanica/Gračanicë, Istog/Istok, Mamuşa/Mamushë/Mamuša, Partesh/Partesh, Podujevë/Podujevo.

<sup>114</sup> Shtatë komuna: Ferizaj/Uroševac, Gračanica/Gračanicë, Istog/Istok, Klinë/Klina, Suharekë/Suva Reka. Takimet e thirrura në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Novo Brdo/Novobërde janë thirrur bashkërisht nga ekzekutivi.

<sup>115</sup> Tre komuna: Mamuşa/Mamushë/Mamuša, Istog/Istok, Podujevë/Podujevo.

<sup>116</sup> Tre komuna: Ferizaj/Uroševac, Istog/Istok, Klinë/Klina.

<sup>117</sup> Gjithashtu, duhet të theksohet se në disa raste, organet e legjislativit dhe ekzekutivit bashkërisht thërrasin takime publike për buxhetin (në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gračanica/Gračanicë, Novo Brdo/Novobërdë, Prizren). Është vërejtur se këto takime zakonisht kryesohen nga zyrtarë nga ekzekutivi



propozimin e buxhetit të realizuar nga kuvendi komunal – përgjithësisht nuk është respektuar për përgatitjen e buxhetit komunal 2013.

### 3.3.2 Njoftimet publike për takimet publike për zhvillimin e buxhetit komunal

Tabela 9 ilustron që për takimet publike në buxhetin komunal të vitit 2013, më shumë komuna kanë nxjerrë së paku një formë të njoftimit publik për takimin publik në gjuhët zyrtare – zakonisht shpallje në faqen e internetit, një broshurë apo afishe.

<b>TABELA 9: Njoftimi publik për takimet publike për zhvillimin e buxhetit</b>	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2012)</b>	<b>Përqindja e komunave (buxheti)</b>
1+takim shpallur dy javë më herët	50 <sup>118</sup>	47 <sup>119</sup>
1+ takim shpallur publikisht në gjuhë zyrtare <sup>120</sup>	44 <sup>121</sup>	62 <sup>122</sup>

Sa i përket njoftimit të takimeve publike, numri i komunave që kanë shpallur një apo më shumë takime publike dy javë më herët është ulur për një nga procesi buxhetor i vitit 2012 në atë të vitit 2013 (shih Tabelën 9).

Mbetet prapë gjendja që komunat priren të jenë më të kujdesshme në nxjerrjen e njoftimeve publike në të dyja gjuhët zyrtare për takimet publike për zhvillimin e buxhetit (shih Tabelën 9) sesa për takimet e organit legjislativ (shih tabelën 4).

Komunat përdorin metoda të njoftimit më të gjerë publik për takime publike sesa për mbledhjet e organit legjislativ, edhe në kuptimin e vendosjes gjeografike të njoftimeve publike, si dhe përdorimin më të madh të metodave alternative si shpalljet në radio. Ashtu si në procesin buxhetor 2012, format më së shpeshti të përdorura të njoftimit publik për takime publike kanë qenë shpalljet në faqen e internetit të komunës, shpalljet (afishe dhe/ose fletushka) të vendosura në ndërtesa komunale apo/dhe tabela të njoftimeve publike, apo kombinimet e këtyre dy formave. Forma tjetër më së shpeshti e përdorur e njoftimit publik është dërgimi i ftesave tek kryetarët e fshatrave, shoqëria civile dhe/ose mediat, pasuar nga shpalljet në radio. Në fakt, për mbledhjet e organeve legjislative, është vërejtur që për procesin buxhetor 2013, më shumë komuna kanë përdorur radion për të shpallur takimet publike për hartimin e buxhetit.<sup>123</sup> Vetëm një komunë ka përdorur shpalljet televizive<sup>124</sup>

<sup>118</sup> Shtatëmbëdhjetë komuna: Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Glllogoc/Glogovac, Gračanica/Gračanicë, Junik, Kaçanik/Kaçanik, Klinë/Klina, Klokot/Klllokot, Lipjan/Lipljan, Malishevë/Mališevo, Parteš/Partesh, Podujevë/Podujevo, Prizren, Skenderaj/Srbica, Suharekë/Suva Reka, Vushtri/Vuçitrn.

<sup>119</sup> Gjashtëmbëdhjetë komuna: Deçan/Deçane, Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Junik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Lipjan/Lipljan, Novo Brdo/Novobërde, Podujevë/Podujevo, Prizren, Shtimë/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Suharekë/Suva Reka, Vushtri/Vuçitrn.

<sup>120</sup> Në rastet e Prizrenit dhe Mamuša/Mamushës/Mamuša, të tri gjuhët zyrtare të komunës.

<sup>121</sup> Pesëmbëdhjetë komuna: Dragash/Dragaš, Gjilan/Gnjilane, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Klokot/Klllokot, Novo Brdo/Novobërde, Obiliq/Obilić, Pejë/Peć, Štrpce/Shtërpçë, Vushtri/Vuçitrn, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gračanica/Gračanicë, Lipjan/Lipljan, Prizren, Ranilug/Ranillug.

<sup>122</sup> Njëzetënjë komuna: Deçan/Deçane, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Gračanica/Gračanicë, Junik, Kamenicë/Kamenica, Klokot/Klllokot, Lipjan/Lipljan, Mitrovicë/Mitrovica, Malishevë/Mališevo, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Novo Brdo/Novobërde, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Parteš/Partesh, Prizren, Ranilug/Ranillug, Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina, Vushtri/Vuçitrn.

<sup>123</sup> Dymbëdhjetë komuna, apo 35 për qind: Deçan/Deçane, Dragash/Dragaš, Glllogoc/Glogovac, Istog/Istok, Kaçanik/Kaçanik, Mitrovicë/Mitrovica, Parteš/Partesh, Podujevë/Podujevo, Shtimë/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Suharekë/Suva Reka, Vushtri/Vuçitrn.

<sup>124</sup> Ferizaj/Uroševac.

ndërsa dy të tjera kanë pasur shpallje në shtyp (gazeta),<sup>125</sup> gjë që përbën ndryshim të vogël nga procesi buxhetor 2012. Gjetjet për procesin buxhetor 2013 gjithashtu kanë shfaqur që shumica e komunave përdorin së paku tri forma të njoftimit publik për të shpallur takimet publike për zhvillimin e buxhetit,<sup>126</sup> kryesisht faqen e internetit të komunës, fletushka dhe/ose afishe, si dhe ftesat individuale.

### 3.3.3 Pjesëmarrja publike në takimet publike për zhvillimin e buxhetit komunal

Kushtet për pjesëmarrjen publike në takimet publike për zhvillimin e buxhetit kanë vazhduar të jenë adekuate për procesin e zhvillimit të buxhetit 2013:

- Gati të gjitha komunat kanë mbajtur takimet publike në salla të përshtatshme për pjesëmarrje publike.<sup>127</sup>
- Sigurimi i përkthimit me gojë në takime publike ka pësuar pak ndryshim: është ofruar në një apo më shumë takime publike në nëntë komuna<sup>128</sup> gjatë proceseve të zhvillimit të buxhetit 2012 dhe në njëmbëdhjetë komuna<sup>129</sup> gjatë zhvillimit të buxhetit 2013. Përkthimi vazhdon të sigurohet në të gjitha rastet kur kërkohet, ose ofrohet pa marrë parasysh kërkesat specifike.

Ngjashëm me procesin e përgatitjes së buxhetit 2012, pjesëmarrja në takime publike ka dalluar nga takimi në takim, bile edhe brenda të njëjtës komunë. Tabela 10 tregon që numri më i shpeshtë i pjesëmarrjeve i shënuar në takimet që diskutojnë buxhetin 2013 ka qenë 30 deri në 39 banorë,<sup>130</sup> pasuar me numrat mes 10 deri në 19 banorë, gjë që çon tek përfundimi që mesatarisht, më shumë njerëz kanë marrë pjesë në takimet publike të procesit buxhetor 2013 sesa në atë të vitit 2012.

<i>TABELA 10: Pjesëmarrja në takime publike</i>	<b>Numri i takimeve (buxheti 2012)</b>	<b>Numri i takimeve (buxheti 2013)</b>
0 banorë	8	8
1 to 9 banorë	9	24
10 to 19 banorë	26	43
20 to 29 banorë	23	24
30 – 39 banorë	18	50
40 – 49 banorë	9	12
50 – 59 banorë	5	8
60 – 69 banorë	3	5
70 – 79 banorë	4	2
80 – 89 banorë	3	2
90 – 99 banorë	0	1

<sup>125</sup> Pejë/Peć, Prishtinë/Priština.

<sup>126</sup> *Tri format* – Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Gjakovë/Đakovica, Hani i Elezit/Elez Han, Kamenicë/Kamenica, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Mitrovicë/Mitrovica, Parteš/Partesh, Podujevë/Podujevo, Rahovec/Orahovac, Ranilug/Ranillug, Štrpce/Shtërpçë. *Four forms*: Glllogoc/Glogovac, Istog/Istok, Klinë/Klina, Lipjan/Lipljan, Novo Brdo/Novobërde, Prishtinë/Priština, Prizren, Shtimë/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Suharekë/Suva Reka. *Five forms*: Deçan/Deçane, Kaçanik/Kaçanik, Pejë/Peć, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>127</sup> Përjashtim përbën Ranilug/Ranillugu dhe Klokot/Klllokoti, që janë komuna të reja, ku hapësirat janë edhe më të kufizuara në ndërtesat ekzistuese.

<sup>128</sup> Njëzetegjashhtë për qind: Dragash/Dragaš, Gjilan/Gnjilane, Štrpce/Shtërpçë, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Kamenicë/Kamenica, Klokot/Klllokot, Lipjan/Lipljan, Novo Brdo/Novobërde, Prizren.

<sup>129</sup> Tridhjetëdy për qind: Dragash/Dragaš, Gjilan/Gnjilane, Graçanica/Graçanicë, Kamenicë/Kamenica, Klokot/Klllokot, Lipjan/Lipljan, Novo Brdo/Novobërde, Parteš/Partesh, Prizren, Rahovec/Orahovac, Ranilug/Ranillug.

<sup>130</sup> Kjo kryesisht për shkak të numrit të takimeve publike të mbajtura në fshatrat e Rahovecit/Orahovac.

100 + banorë	3 <sup>131</sup>	3 <sup>132</sup>
--------------	------------------	------------------

Identifikimi i metodave që janë të suksesshme në tërheqjen e më shumë banorëve në takime publike ende tregohet të jetë sfidues. Sigurisht, sa më shumë takime publike që thirren nga komuna, sidomos nëse mbahen në vende të ndryshme, aq më shumë banorë do të mbulohen. Gjetjet e monitorimit nga OSBE-ja nuk tregojnë që ka pjesëmarrje më të madhe nëse njoftimi bëhet më herët. Megjithatë, në përgjithësi procesi buxhetor priret të tërheqë numra më të mëdhenj të banorëve kah takimet publike, nëse ka një mbulim më të gjerë të njoftimit, në kuptimin gjeografik por edhe në kuptimin e formave të ndryshme të njoftimit.

Në bazë të rekomandimeve të mëhershme, OSBE-ja ka grumbulluar të dhëna për disa kategori të reja për takimet publike të mbajtura për të marrë mendimet e publikut në buxhetet komunale të vitit 2013. Së pari, në përputhje me rekomandimin që komunat të përgatisin dhe të shpallin publikisht një orar të takimeve publike që në fillim të procesit të zhvillimit të buxhetit, 16 komuna kanë shpallur publikisht listën e takimeve në maj, qershor apo korrik.<sup>133</sup> Së dyti, OSBE-ja ka rekomanduar që komunat të organizojnë takimet publike pas orarit të punës (pas orës 16:00) për të lehtësuar pjesëmarrjen publike. Afërsisht 45 për qind të takimeve publike të monitoruara gjatë procesit buxhetor 2013 janë mbajtur pas orarit të punës. Me fjalë të tjera, pesëmbëdhjetë komuna kanë mbajtur së paku një takim publik pas orarit të punës;<sup>134</sup> përveç kësaj, 12<sup>135</sup> prej tyre kanë mbajtur shumicën e takimeve publike pas orarit të punës. Së treti, Raporti 2012 ka rekomanduar që komunat të mbajnë disa takime publike jashtë qendrës së komunës për të siguruar mbulim më të madh të banorëve. Një zhvillim pozitiv është shënuar në këtë fushë: derisa për zhvillimin e buxhetit 2012, 14<sup>136</sup> komuna kanë mbajtur së paku një takim publik jashtë qendrës së komunës, 21 e kanë bërë këtë për buxhetin 2013.<sup>137</sup> Së katërti, është rekomanduar që materialet e shkruara, sidomos kopjet e kornizës afatmesme buxhetore dhe propozim-buxhetit, të shpërndahen tek banorët në takime publike. Kopjet apo përmbledhjet e dokumenteve buxhetore janë shpërndarë në një apo më shumë takime publike në 22 komuna gjatë hartimit të buxheteve më 2013.<sup>138</sup> Përfundimisht, komunave gjithashtu iu është rekomanduar që të sigurojnë që të dy këto dokumente të jenë në

<sup>131</sup> 100 (Kaçanik/Kaçanik), 130 (Gračanica/Gračanicë), dhe 140 (Podujevë/Podujevo).

<sup>132</sup> 120 (Hani i Elezit/Elez Han), 105 (Kaçanik/Kaçanik), 100 (Kamenicë/Kamenica).

<sup>133</sup> Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Junik, Kamenicë/Kamenica, Klokot/Kllokot, Lipjan/Lipljan, Mitrovicë/Mitrovica, Obiliq/Obilić, Prishtinë/Priština, Prizren, Ranilug/Ranillug, Skenderaj/Srbica, Shtimë/Štimlje, Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>134</sup> Dyzetekatër për qind: Deçan/Deçane, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjakovë/Đakovica, Glogoc/Glogovac, Gračanica/Gračanicë, Hani i Elezit/Elez Han, Istog/Istok, Mitrovicë/Mitrovica, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Prizren, Rahovec/Orahovac, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>135</sup> Tridhjetëpesë për qind: Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjakovë/Đakovica, Glogoc/Glogovac, Gračanica/Gračanicë, Hani i Elezit/Elez Han, Istog/Istok, Mitrovicë/Mitrovica, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Prizren, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>136</sup> Dyzetenjë për qind: Ferizaj/Uroševac, Gračanica/Gračanicë, Istog/Istok, Kamenicë/Kamenica, Lipjan/Lipljan, Mitrovicë/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërde, Parteš/Partesh, Prishtinë/Priština (in neighbourhoods), Prizren, Rahovec/Orahovac, Ranilug/Ranillug, Shtimë/Štimlje, Viti/Vitina.

<sup>137</sup> Gjashtëdhjetëdy për qind: Deçan/Deçane, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjakovë/Đakovica, Glogoc/Glogovac, Gračanica/Gračanicë, Hani i Elezit/Elez Han, Istog/Istok, Lipjan/Lipljan, Mitrovicë/Mitrovica, Novo Brdo/Novobërde, Parteš/Partesh, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština (në lagje), Prizren, Rahovec/Orahovac, Ranilug/Ranillug, Shtimë/Štimlje, Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>138</sup> Gjashtëdhjetëpesë për qind: Deçan/Deçane, Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Glogoc/Glogovac, Gjilan/Gnjilane, Gračanica/Gračanicë, Istog/Istok, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Mitrovicë/Mitrovica, Mamuşa/Mamushë/Mamuşa, Novo Brdo/Novobërde, Obiliq/Obilić, Podujevë/Podujevo, Prizren, Skenderaj/Srbica, Shtimë/Štimlje, Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn.

dispozicion në faqen e internetit të komunës në kohën e duhur, ashtu siç kërkohet.<sup>139</sup> Që prej dhjetorit 2012, gjysma e komunave të vlerësuara kishin vendosur njërin apo të dy dokumentet në faqen e internetit të komunës,<sup>140</sup> që është përmirësim i lehtë në krahasim me buxhetin 2013, pasi që dy komuna më shumë kanë vendosur dokumentet në faqen e internetit.

OSBE-ja gjithashtu ka përcjellur edhe pjesëmarrjen e grave në takimet publike për buxhetet komunale të vitit 2013. Monitorimi ka treguar që gratë kanë qenë të pranishme në afërsisht 37 për qind të këtyre takimeve. Megjithatë, pjesëmarrja ka qenë përgjithësisht e dobët: mes një dhe katër gra kanë marrë pjesë në shumicën dërmuese të këtyre takimeve.<sup>141</sup> Brengat në lidhje me financat komunale me ndjeshmëri gjinore janë theksuar në gjashtë takime publike në gjashtë komuna.<sup>142</sup> Të ngritura nga zyrtarët komunalë dhe banorët/përfaqësuesit e shoqërisë civile, brengat e tilla kanë të bëjnë kryesisht me financimin e aktiviteteve për promovimin e barazisë gjinore, ose me pyetje në lidhje me praktikën e buxhetimit gjinor.

Përveç këtyre, OSBE-ja ka mbledhur informata nga banorët pjesëmarrës të takimeve publike mbi formën e njoftimit që e ka njoftuar atë për atë takim.<sup>143</sup> Tabela 11 ofron informata mbi përgjigjet e dhëna nga qytetarët, të ndarë sipas gjinisë së të anketuarve. Përveç formave më të shpeshta të njoftimit publik të përdorura nga komuna (faqja e internetit dhe fletushkat/afishet), edhe kontaktet personale kanë luajtur rol të konsiderueshëm në njoftimin e banorëve për takimet publike për buxhetin 2013, e sidomos të grave. Është gjithashtu me rëndësi të theksohet që ftesat personale janë raportuar më shumë nga gratë sesa nga meshkujt, si dhe që mediat tradicionale (TV, Radio dhe mediat elektronike) nuk kanë pasur fare rol në informimin e grave për takimin publik.

<i>TABELA 11: Përgjigjet nga banorët për format e njoftimit</i>	<b>Meshkuj (si % e 245 burrave të intervistuar)</b>	<b>Femra (si % e 51 grave të intervistuar)</b>
Faqja komunale e internetit	20%	20%
Broshura/posterë	39%	24%
Shpallje në radio	6%	6%
Shpallje në TV	2%	0
Shtypi (gazetat)	0	0
Mediat elektronike	0	0
Kontaktet personale	28%	39%
Ftesat personale	5%	11%

Në fund, tabela 12 tregon që pjesëmarrja e përfaqësuesve të shoqërisë civile në takime publike të zhvillimit të buxhetit 2013 është gati e njëjtë me atë të përfaqësuesve të mediave (24, respektivisht 25 për qind), derisa nuk ka dallim në pjesëmarrjen e përfaqësuesve të mediave në takimet publike për zhvillimin e buxhetit më 2012 dhe 2013.

<sup>139</sup> Faqe 16 dhe 18, Qarkorja Komunale Buxhetore 2013/01, Ministria e Financave, 11 maj 2012.

<sup>140</sup> Pesëdhjetë për qind: Gjilan/Gnjilane, Gračanica/Gračanicë, Hani i Elezit/Elez Han, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Klokot/Killokot, Malishevë/Mališevo, Novo Brdo/Novobërde, Podujevë/Podujevo, Prizren, Rahovec/Orahovac, Ranilug/Ranillug, Shtimë/Štimlje, Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>141</sup> Gjashtëdhjetëdhjetë takime: një deri në katër gra kanë marrë pjesë në 47 takime; pesë deri në 10 gra kanë marrë pjesë në nëntë takime; 11 – 19 gra kanë marrë pjesë në gjashtë takime; 20 – 29 gra kanë marrë pjesë në dy takime; 30 – 39 gra kanë marrë pjesë në dy takime; si dhe 45 gra kanë marrë pjesë në një takim.

<sup>142</sup> Deçan/Deçane, Klinë/Klina, Lipjan/Lipljan, Novo Brdo/Novobërde, Prizren, Ranilug/Ranillug.

<sup>143</sup> Dyqindedyzetepesë burra dhe pesëdhjetënjë gra janë pyetur se si kanë kuptuar për takimin.

<i>TABELA 12: Pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe mediave në takime publike</i>	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2012) (%)</b>	<b>Përqindja e komunave (buxheti 2013) (%)</b>
Shoqëria civile e pranishme në 1+ takime	Nuk ka të dhëna	71 <sup>144</sup>
Mediat të pranishme në 1+ takime	74 <sup>145</sup>	74 <sup>146</sup>

#### 4. PËRFUNDIMI

Në bazë të krahasimit të gjetjeve të përshkruara si më lart në lidhje me zhvillimin e buxheteve të vitit 2012 dhe 2013 në Kosovë, rekomandimet në vijim, të dhëna nga OSBE-ja për institucionet lokale, në vlerësimin e saj të mëparshëm, janë zbatuar deri në një masë nga komunat e vlerësuara:

- Rekomandimi 1: Përgatitja dhe shpallja publike e listës së takimeve që në fillim të procesit të zhvillimit të buxhetit vjetor, për të dhënë kohë të mjaftueshme për njoftimin publik të takimeve. Zbatimi: *Gati gjysma e komunave e kanë bërë këtë në maj, qershor apo korrik.*
- Rekomandimi 2: Rritja e vetëdijes së banorëve duke zgjeruar gjeografikisht njoftimin publik në gjithë komunën, si dhe duke përdorur metoda alternative të njoftimit, si shpalljet në radio dhe në shtypin e shkruar, afishet/njoftimet në hapësira publike në gjithë komunën, etj. Zbatimi: *Në krahasim me vitin e kaluar, tri komuna më shumë kanë përdorur shpalljet në radio për njoftim të takimeve për buxhetin 2013; megjithatë, ka ende hapësirë për përmirësim në këtë fushë.*
- Rekomandimi 3: Të mbahen takimet pas orarit të rregullt të punës, për të mundësuar pjesëmarrjen publike, si dhe të mbahen disa takime jashtë qendrës së komunës për të siguruar mbulueshmëri më të madhe të banorëve. Zbatimi: *Gati gjysma e komunave të vlerësuara kanë mbajtur takime pas orarit të rregullt të punës. Ka pasur gjithashtu rritje të numrit të komunave që kanë mbajtur takime jashtë qytetit/fshatit kryesor për buxhetin 2013.*
- Rekomandimi 4: Të sigurohet që njoftimi publik të mbulojë gjitha komunitetet, duke nxjerrë njoftime publike në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë/komunë, sipas kërkesës. Zbatimi: *Në krahasim me vitin e kaluar, gjashtë komuna më shumë kanë shpallur takimet publike në gjuhët zyrtare për procesin buxhetor 2013; megjithatë, nuk ka pasur ndryshime*

<sup>144</sup> Njëzetekatër komuna: Deçan/Deçane, Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjakovë/Đakovica, Gjilan/Gnjilane, Gračanica/Gračanicë, Hani i Elezit/Elez Han, Istog/Istok, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Klokot/Kllokot, Lipjan/Lipljan, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prizren, Rahovec/Orahovac, Ranilug/Ranillug, Shtimë/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Suharekë/Suva Reka, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>145</sup> Njëzetepesë komuna: Deçan/Deçane, Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Hani i Elezit/Elez Han, Istog/Istok, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Klokot/Kllokot, Lipjan/Lipljan, Malishevë/Mališevo, Mitrovicë/Mitrovica, Partesh/Partesh, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prizren, Rahovec/Orahovac, Ranilug/Ranillug, Shtimë/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Suharekë/Suva Reka, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn.

<sup>146</sup> Njëzetepesë komuna: Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Gjakovë/Đakovica, Gjilan/Gnjilane, Glogoc/Glogovac, Gračanica/Gračanicë, Hani i Elezit/Elez Han, Istog/Istok, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Malishevë/Mališevo, Novo Brdo/Novobërde, Obiliq/Obilić, Partesh/Partesh, Pejë/Peć, Podujevë/Podujevo, Prizren, Rahovec/Orahovac, Ranilug/Ranillug, Shtimë/Štimlje, Skenderaj/Srbica, Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina, Vushtrri/Vučitrn.

*të mëdha në kuptimin e njoftimit publik të mbledhjeve të organeve legislative në gjuhët zyrtare.*

- Rekomandimi 5: Të sigurojnë materialet me shkrim posaçërisht projekt-kopjet e kornizës afatmesme buxhetore dhe të propozim-buxhetit për të gjithë banorët në të gjitha takimet për zhvillimin e buxhetit. Po ashtu, të sigurojnë që të dyja dokumentet janë në dispozicion me kohë në ueb faqen komunale. Zbatimi: *Kopjet apo përmbledhjet e dokumenteve buxhetore janë shpërndanë në një apo më shumë takime publike në 22 komuna; sidoqoftë sa i përket vënies në dispozicion të të dyja dokumenteve të miratuara në ueb faqen komunale, është vërejtur pak përparim për dokumentet buxhetore të vitit 2013.*
- Rekomandimi 6: Dega legislative duhet të sigurojë që të mos anashkalohej rishikimi dhe miratimi i propozim-buxhetit nga ana e komitetit për financa dhe politika dhe komitetit për komunitete. Zbatimi: *Rishikimi dhe miratimi i të dyja dokumenteve buxhetore nga ana e komitetit për financa dhe politika u përmirësua gjatë procesit buxhetor të vitit 2013 edhe në tetë komuna të tjera; megjithatë komitetet për komunitete mbesin kryesisht të përjashtuara nga procesi i zhvillimit të buxhetit.*

Megjithatë ka shumë pak dëshmi se janë ndërmarr nisma për zbatimin e rekomandimeve si në vijim nga raporti i OSBE-së për vitin 2012:

- Rekomandimi 1: Të ndërmarrin angazhime alternative për të marrë mendime dhe reagime të publikut për buxhetin komunal siç janë debatet televizive dhe takimet konsultative me grupe të veçanta të interesit si grupet e grave, grupet rinore, etj.
- Rekomandimi 2: Të nxjerrin përditësime të rregullta për procesin e përgatitjes buxhetore përmes mediave dhe në faqet e internetit të komunave.
- Rekomandimi 3: Dega legislative duhet ta ushtrojë rolin e saj mbikëqyrës duke kërkuar nga dega ekzekutive raportim të rregullt për përparimin e arritur në përgatitjen e Kornizës afatmesme buxhetore dhe propozim buxhetin. Kjo do ta përmirësonte përputhshmërinë me afatet kohore për miratimin e buxhetit të përvijuar në kornizën ligjore.

Përveç kësaj dhe përtej përpjekjeve për zbatimin e rekomandimeve të lartcekura, u vërejtën zhvillime të tjera pozitive gjatë procesit të zhvillimit të buxhetit për vitin 2013 në krahasim me procesin për zhvillimin e buxhetit për vitin 2012:

- Së pari, u përmirësua përputhshmëria me afatet kohore për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore nga komiteti për politika dhe financa dhe kuvendi i komunës. Për më tepër, më pak komuna miratuan të dyja dokumentet, pra kornizën afatmesme buxhetore a propozim-buxhetin, si një “pako” të vetme.
- Së dyti, u vërejtën përmirësime në lidhje me njoftimin me kohë të takimeve të degës legislative për rishikimin dhe/ose miratimin e buxheteve për vitin 2013.
- Së treti, u shtua pjesëmarrja e banorëve në takimet e komitetit për financa dhe politika dhe komitetit për komunitete për zhvillimin e buxhetit të komunës për vitin 2013, ndonëse me një shkallë të vogël.
- Përfundimisht, kishte një rritje të rëndësishme – rreth 80 për qind – në numrin e takimeve publike që u thirrën për të marrë kontributin e publikut për buxhetet komunale për vitin 2013. Secila komunë që iu nënshtrua vlerësimit jo vetëm që thirri së paku një takim publik për zhvillimin e buxhetit por edhe numri i banorëve të cilët morën pjesë në secilin takim publik ishte mesatarisht më i madh për buxhetin e vitit 2013 sesa për buxhetin e vitit 2012.

Në fushat e tjera kyçe, nuk u vërejt ndonjë përparim apo u vërejt edhe regres:

- Së pari, numri i komunave ku kryetari përmbushi afatin e 1 shtatorit për dorëzimin e projekt propozim-buxhetit në kuvendin e komunës mbeti i njëjtë për procesin e zhvillimit të buxhetit për vitin 2013.
- Së dyti, edhe në rastet kur qytetarët morën pjesë në takimet e degës legislative për rishikimin dhe/ose miratimin e buxhetit, përqindja e regjistruar mbeti e vogël.
- Së treti, në lidhje me procesin e zhvillimit të buxhetit për vitin 2013, në shumë komuna munguan në shkallë të konsiderueshme përpjekjet për konsultime publike nga dega legislative, siç ishte rasti për procesin e zhvillimit të buxhetit për vitin 2012; në të vërtetë, numri i komunave ku vetëm dega ekzekutive thirri takimet publike u rrit për procesin e vitit 2013, ndonëse jo në numër të madh. Për më tepër, shumica dërmuese e kuvendeve komunale nuk thirrën së paku një takim publik për propozim-buxhetin e komunës pas pranimit të tij nga ana e kryetarit të komunës.
- Së katërti, përkitazi me njoftimin me kohë të takimeve publike, duhet të përmirësohet respektimi i kërkesës për njoftim dy javë para mbajtjes së takimit.
- Përfundimisht, asnjë komunë nuk ka përmbushur të gjitha kërkesat e konsultimit publik siç përcaktohen me anë të Qarkores Buxhetore në kuptim të thirrjes së takimeve publike nga dega legislative dhe ekzekutive për kornizën afatmesme buxhetore dhe propozim-buxhetin.

Duhet të theksohet se në fushat e tjera, posaçërisht në sigurimin e hapësirës së mjaftueshme dhe përkthimit me gojë në takime, respektimi i kërkesave ishte i kënaqshëm për proceset e zhvillimit të buxhetit për vitin 2012 dhe atë 2013.

Në lidhje me Ministrinë e Financave, ende duhet të vazhdohet me zbatimin e rekomandimeve të OSBE-së që janë paraqitur në raportin e vitit 2012. Përkitazi me rekomandimet për organizatat e shoqërisë civile, në punëtoritë e organizuara nga OSBE-ja me hisedarët gjegjës u theksua se pjesëmarrja në proceset e vendimmarrjes në nivel komunal mbetet e pamjaftueshme. Kjo mund t'i ngarkohet mungesës së besimit në institucionet publike nga ana e qytetarëve si dhe informatave të pamjaftueshme për politikën dhe vendimet komunale. Me disa përjashtime, organizatat që punojnë në nivel komunal gjithashtu ballafaqohen me mungesë të burimeve, e që vështirëson aftësinë e tyre për t'i mbajtur llogaridhënëse qeveritë komunale. Duke qenë kështu, organizatat e shoqërisë civile duhet të vazhdojnë me përpjekjet e tyre për t'u angazhuar me komunat dhe qytetarët ashtu që një gamë e gjerë e interesave publike të merret parasysh nga vendimmarrësit komunalë.

## 5. REKOMANDIMET

Përveç rekomandimeve që janë paraqitur në raportin e vitit 2012 dhe që janë cekur në hollësi në pjesën 4 më sipër, OSBE-ja rekomandon si në vijim:

### *Për Ministrinë e Financave*

- Të shtojë shkëmbimin e informatave me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila mbikëqyr takimet e kuvendeve komunale, gjatë periudhës së rishikimit dhe miratimit të buxhetit për të trajtuar mangësitë përkitazi me mbikëqyrjen legislative të procesit të zhvillimit të buxhetit.

### *Për komunat*

- Kryetari i komunës dhe/ose drejtorja komunale e buxhetit dhe financave duhet të ndërmerr nisma për të siguruar përditësime të rregullta për procesin e zhvillimit të buxhetit në takimet e organeve legjislative gjatë periudhës vjetore të rishikimit dhe miratimit të buxhetit. Kjo do të shtonte përputhshmërinë me afatet kohore për miratimin e buxhetit ashtu siç përcaktohet me kornizën ligjore.
- Organet ekzekutive dhe ato legjislative në mënyrë sistematike duhet të përcjellin se deri në çfarë shkallë përfshihen kërkesat dhe komentet nga banorët, të cilët marrin pjesë në takimet publike për buxhetin e vitit të ardhshëm, në kornizën afatmesme buxhetore dhe propozim-buxhetin që miratohen. Kjo informatë duhet të bëhet publike.
- Të nxirren përditësime të rregullta për procesin e zhvillimit të buxhetit duke përfshirë datat e të gjitha takimeve të organeve legjislative dhe të takimeve publike, përmes mjeteve standarde të informimit dhe mjeteve të mediave sociale.
- Të përdorin zyrtarin komunal për barazi gjinore dhe grupin e grave, aty ku janë themeluar, për të ndërgjegjësuar gratë dhe për të trimëruar pjesëmarrjen e tyre në procesin e zhvillimit të buxhetit. Ftesat personale që u janë bërë grave dolën se janë një mjet produktiv në procesin e zhvillimit të buxhetit për vitin 2013.



## SHTOJCA 1

### *Mbështetja e ofruar nga OSBE-ja për të shtuar respektimin e kritereve për zhvillimin e buxheteve komunale për vitin 2013*

Ashtu si edhe në vitet e mëparshme, ekipet fushore të OSBE-së përkrahën zyrtarët kyçë komunalë, përgjatë gjithë procesit të zhvillimit dhe miratimit të buxhetit, për të përmbushur afatet kohore të detyrueshme dhe për t'ju përmbajtur kërkesave për konsultim publik. Komunitet në veçanti u inkurajuan për të ndërgjegjësuar gratë, komunitetet joshumicë dhe banorët e vendbanimeve rurale. Përveç punës së tillë të përditshme monitoruese dhe avokuese, OSBE-ja ofroi mbështetjen e saj për të gjitha 34 komunat që iu nënshtruan vlerësimit me qëllim të përkrahjes së tyre për të përmirësuar respektimin e kërkesave ligjore të procesit për zhvillimin e buxhetit për vitin 2013:

- Në prill, OSBE-ja shtypi dhe shpërndau afishet për komunat për shpalljen e takimeve publike për buxhetin e vitit 2013.<sup>147</sup>
- Në qershor u krye një vizitë studimore në Bon të Gjermanisë për përfaqësuesit e komunave Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Glllogoc/Glogovac, Kamenicë/Kamenica, Mitrovicë/Mitrovica dhe Vushtrri/Vučitrn dhe Ministrisë së Financave. Komunitet pjesëmarrëse u përzgjedhën në bazë të respektimit të kornizës ligjore për zhvillimin e buxhetit për vitin 2011. Vizita studimore u ofroi pjesëmarrësve një mundësi për të mësuar më shumë për praktikën më të mirë në planifikimin e buxhetit, zhvillimin e buxhetit që merr parasysh aspektin gjinor dhe pjesëmarrjen publike. Në të vërtetë, përveç njërës komunë<sup>148</sup>, të gjitha komunat e tjera i shtuan përpjekjet në vitin 2012 për të konsultuar qytetarët gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit.<sup>149</sup>
- Në qershor, OSBE-ja dhe Departamenti i Buxheteve Komunale i Ministrisë së Financave organizoi një forum dyditor për përfaqësuesit e komunave mbi zbatimin e Qarkores Buxhetore Komunale 2013/01.<sup>150</sup>
- Në korrik, OSBE-ja organizoi një punëtori në bashkëpunim me projektin e binjakëzimit të Bashkimit Evropian “Bashkëpunimi evropian për komuna më të fuqishme” për përfaqësuesit e komunave dhe ministrive të linjës.
- Në qershor dhe korrik, OSBE-ja organizoi pesë punëtori njëditore për zhvillimin e buxhetit që merr parasysh aspektin gjinor. Qëllimi i punëtorive ishte që t'ju ofronte zyrtarëve komunalë të degës ekzekutive dhe legjislative dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile një hyrje për shqyrtimin e buxheteve komunale nga pikëpamja gjinore.<sup>151</sup>
- Nga muaji korrik deri në muajin shtator, u mbajtën 28 punëtori komunale nga drejtorët komunalë të buxheteve dhe financave dhe/ose zyrtarët kryesorë financiarë me mbështetjen e OSBE-së. Punëtoritë u përqendruan në kriteret ligjore të procesit të zhvillimit të buxhetit për vitin 2013.<sup>152</sup>
- Në nëntor, OSBE-ja në bashkëpunim me Departamentin e Buxheteve Komunale të Ministrisë së Financave organizoi një forum për shkëmbimin e praktikave më të mira mbi

<sup>147</sup> Projekt i Seksionit për Qeverisje Lokale – *Lehtësimi i shkëmbimit të praktikave më të mira komunale II*.

<sup>148</sup> Kamenicë/Kamenica.

<sup>149</sup> Projekt i Seksionit për Qeverisje Lokale – *Lehtësimi i shkëmbimit të praktikave më të mira komunale II*.

<sup>150</sup> Projekt i Seksionit për Qeverisje Lokale – *Përkrahja për dialogun në mes të nivelit qendror dhe lokal për zbatimin efikas të kompetencave komunale*.

<sup>151</sup> Projekt i Seksionit për Qeverisje Lokale – *Lehtësimi i shkëmbimit të praktikave më të mira komunale II*.

<sup>152</sup> Projekt i Seksionit për Qeverisje Lokale – *Përkrahja për dialogun në mes të nivelit qendror dhe lokal për zbatimin efikas të kompetencave komunale*.

procesin e zhvillimit të buxhetit komunal për përfaqësuesit e komunave dhe ministrive të linjës.<sup>153</sup>

- Në nëntor, OSBE-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal organizoi një punëtori për vlerësimin e përparimit të shënuar në pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në çështjet e qeverisjes lokale për vitin 2012. Pjesëmarrësit diskutuan, ndër të tjera, modalitetet për përmirësimin e pjesëmarrjes publike në procesin e zhvillimit të buxhetit për vitet e ardhshme.
- Gjatë gjithë vitit, OSBE-ja ofroi përkrahje të përshtatur sipas nevojës për programet e ndërgjegjësimit dhe strategjitë e përfshirjes së publikut në Podujevë/Podujevo dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje.<sup>154</sup> Në tetor, OSBE-ja ofroi seanca trajnimit shtesë për grupin e grave në rajonin e Prizrenit mbi zhvillimin e buxhetit që merr parasysh aspektin gjinor.<sup>155</sup>

---

<sup>153</sup> Projekt i Seksionit për Qeverisje Lokale– *Lehtësimit i shkëmbimit të praktikave më të mira komunale II*.

<sup>154</sup> Projekt i Seksionit për Qeverisje Lokale– *Lehtësimit i shkëmbimit të praktikave më të mira komunale II* dhe projekt i Qendrës Rajonale Prishtinë/Priština të OSBE-së – *rritja e pjesëmarrjes publike dhe vetëdijesimit në planifikimin e buxhetit komunal në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje*.

<sup>155</sup> Projekt i Qendrës Rajonale Prizren – *rritja e pjesëmarrjes së gruas në proceset lokale të vendimmarrjes në rajonin e Prizrenit*.